VENDIM
Nr. 93, datë 20.4.2018

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË SHOQËRISË "OSOJA ENERGY" SHPK, PËR LICENCIM NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK SEMAN-1, SHEQ, MARINAS, FIER ME KAPACITET TË INSTALUAR 2000 kw

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa "a", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa "a"; të nenit 5, pika 1, germa "a"; të nenit 10, pika 3 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016; të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa "a" e të "Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e bordit nr. 96, datë 17.6.2016;, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.4.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë "Osoja Energy" sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaik Seman-1 Sheq, Marinas, Fier, me kapacitet të instaluar 2000 kw,

Konstatoi se:

- Me shkresën e datës 11.4.2018, protokolluar në ERE, me nr. 310, datë 11.4.2018, shoqëria "Osoja Energy" sh.p.k. ka paraqitur kërkesë për t'u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaik Seman-1 Sheq, Marinas, Fier me kapacitet të instaluar 2000 kw.

- Bazuar në autorizimin paraprak me nr. 1583/7 prot., datë 15.5.2017, lëshuar nga Ministria Energjisë dhe Industrisë në favor të shoqërisë "Osoja Energy" sh.p.k, në pajtim me nenin 19, pika 2 e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 822, datë 7.10.2015, "Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni", ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 718, datë 12.10.2016, kjo shoqëri në objekt të veprimtarisë së saj ka projektimin e të gjitha llojeve të veprave energjetike; ndërtimin e hidrocentraleve, termocentraleve, impianteve me erë, impianteve solare, shitjen e energjisë elektrike, transmetimin e energjisë elektrike në sistemin e tensionit të lartë, shpërndarjen e energjisë elektrike; implementimin dhe menaxhimin e projektit gjenerues të energjisë elektrike nga fotovoltaik dhe veprave ndihmëse në zonën Sheq, Marinas, Seman, Fier.

- Shoqëria "Osoja Energy" sh.p.k., ka depozituar në ERE kontratën me nr. 1163 rep. dhe nr. 376 kol., datë 29.12.2017, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe shoqërisë "Osoja Energy" sh.p.k., për "Ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e Centralit Fotovoltaik "Seman-1", bazuar në nenin 25 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 822, datë 7.10.2015, referuar miratimit përfundimtar me nr. 3887/2 prot., datë 23.12.2017, me kapacitet prodhues 2000 kw, Qarku Fier. Në nenin 3 të kontratës, janë përcaktuar koordinatat për ndërtimin e Centralit Fotovoltaik Seman-1 në zonën Sheq, Marinas, Seman, Fier.

- Aplikimi i shoqërisë "Osoja Energy" sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara në "Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, germat "a", "b" dhe "c") është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat "a", "b", "c", "e", "f", "g") është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat "a", "b", "c", "d") është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni tekniko-ekonomik (neni 9, pikat 4.4.1 4.4.2, 4.4.3 (germat "a", "b" "c", "d"), 4.4.4 (germat "a", "b", "d") dhe 4.4.5 (germat "a", "b") është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Nenin 9, pika 4.4.4, germa "c" (oponenca teknike e projektit), do të njoftohet subjekti që t'i paraqesë ato brenda afateve që përcakton "Rregullorja për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike".

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë "Osoja Energy" sh.p.k., për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaik Sheq, Marinas, Seman, Fier, me kapacitet të instaluar 2000 kw.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti